

bredaloret.com



NEW DAMPER



NJË TEKNOLOGJI E RE QËMODIFIKON NË MËNYRË RADIKALE IDENË E PULEXHO-NXJERRËSIT.

- Dallimet ndërmjet pulexhës tradicionale (Damper) dhe pulexhave të konceptit të ri (New Damper) janë të shumta dhe të gjitha me përmbajtje të larte teknike. Dallime që kanë çuar disa nga prodhuesit kryesorë të makinave të adoptojnë produktin e ri për tregun e aksesorëve.

PULEXHAT DAMPER TRADICIONALE

1



Në përgjithësi pulexhat Damper tradicionale (Fig.1) formohen nga një bërthamë prej çeliku që bashkohet në formë të ngurtë me boshtin e motorit, nga një unazë gome që ndan bërthamën nga trupi i jashtëm, dhe nga një trup i jashtëm që prezanton kanalet për vendosjen e rripave.

PULEXHAT NEW DAMPER

2



Ndërkohë, "New Damper" përbëhet nga një bllok unik çeliku me kanale gome (Fig. 2).

PULEXHAT DAMPER TRADICIONALE

Pulexhat tradicionale kanë një strukturë komplekse, e projektuar për të tërhequr rripin ndihmës, por sidomos për të kufizuar dridhjet dhe zhurmën.

**FAKTI QË
JANË SHUMË
KOMPLEKSE,
I BËN SUBJEKT RASTESH
KEQFUNKSIONIMI.**

PËR SHEMBULL – PULEXHA E BOSHTIT MOTOR BMW

Ref. Orig. 11237793593 (fig. 3, 4, 5)

REZULTATI FINAL: Thyerje dhe rënie totale e pjesës së gomës.

Ndarja e pjesëve metalike. Dalje e mbajtësit të rripit.

Zhvendosje dhe mbivendosje e pjesëve metalike.



● DRIDHJET:

mund të ndodhin në tërësinë e pjesëve ndihmëse, për shkak se pulexha ka nivele rrëshqitjeje anësore të gomës, për shkak të një vendosjeje të spostuar.

● EFEKTI KOHË:

mirëmbajtja e karakteristikave fizike të përbërjes së gomës ndikohet nga koha.

Procesi i vjetërsimit të gomës shkakton ngurtësimin e përbërjes, duke prodhuar të çara tërthore, dhe shkakton rrezikun e shkatërrimit.

● EFEKTI REZONANCË:

rezonanca në motorët me naftë është shtuar ndjeshëm (Hdi, Dti, Tdi), veçanërisht tek motorët me cilindrat të lartë (kamion, SUV).

Ky efekt mund të jetë shkak i defektit ose thyerjes së pulexhës për shkak të sforcimit të tepërt, i ndikuar nga shtimi i dridhjeve rrotulluese të motorit.

● EFEKTI TEMPERATURË:

për temperaturën e funksionimit të motorit dhe dridhjeve të tij, goma e vendosur plasaritet dhe shkëputet nga pjesët metalike. Pjesët e gomës së shkëputur, mund të ndërhyjnë tek rripi ndihmës dhe të komprometojnë pjesë të tjera të qarkut të transmetimit.


● EFEKTI KINETIK:

impulset inerciale të motorit ushtrojnë një përdorim force rezistuese të gomës që unifikon pjesët metalike të pulexhës. Ky efekt, në funksion të intensitetit të forcës kinetike dhe të kohës, mund të rezultojë në thyrje të parakohshme të pulexhës, duke çliruar dridhjet rrotulluese të boshtit të motorit.

PULEXHAT NEW DAMPER

● TEKNOLOGJIA E RE E PËRDORUR PËR PËRDORIMIN E PULEXHAVE "NEW DAMPER" MUNDËSON TË KENI PULEXHA QË NUK THYHEN DHE NUK KANË PROBLEME DRIDHJESH.

● "NEW DAMPER" JANË PROJEKTUAR DUKE NDJEKUR PARAMETRAT E PRODHUESVE (PËR SHEMBULL GRUPI VAG DHE MERCEDES) QË PËRDORIN PULEXHA ME TRUP TË UNIFIKUAR ME PËRBËRËS ELASTIK PËR TË ZVOGËLUAR DRIDHJET DHE AMORTIZUAR REZONANCËN.



Këto pulexha kanë gjithashtu karakteristika më të larta të fuqisë transmetuese. Vendosi me çiftin e kontrolluar në boshtin e motorit, simetria e profilit të jashtëm që transmeton rrotullimin e rripit me shumë kanalë (poly-v), kompaktësia e konstruktionit të çelikut që nuk humb pjesë të shkëputura, janë elementet bazë të besueshmërisë së pulexhave "New Damper" të garantuara me 150.000 Km jetëgjatësi.

PRODHIMI Uzina e punësuar është testuar deri sa të përfitohej një aliazh çeliku, struktura e të cilit ofron densitetin dhe fleksibilitetin e duhur duke zhvilluar një material fleksibël dhe poroz, thelbësor për zbatimin e projektit. Procesi i mekanizimit është tërësisht i robotizuar, duke dhënë një kapacitet të lartë prodhimi ndërsa për procesin e injektimit të gomës (580-890 bar) përdoret një polimer termik, goma EPDM, e përdorur nga prodhuesit më të mëdhenj. Goma është shumë e qëndrueshme, me temperaturë pune që mund të arrijnë 210°C.

BALANCIMI Falë mbështetjes së repartit të inxhinierisë së disa prodhuesve të mëdhenj të makinave, është zhvilluar një proces efikas balancimi: me ndihmën e një makine dixhitale të robotizuar është e mundur vetëkalibrimi i çdo pjese, duke arritur si objektivi një balancim dinamik prej 0,1gr/cm. Ky kontroll, veç të tjerave, nxjerr në pah dridhjet nga zbalancime të mundshme, duke i korrigjuar nëse është e nevojshme, nëpërmjet një procesi automatik që i sjell brenda parametrave të kërkuar nga specifikimet e pajisjeve origjinale. Efektiviteti i procesit, mundëson të shmangësh problemet mekanike në aplikimin e pulexhave.

KITI Në studimin e procesit është zgjedhur të përfshihet edhe dinamoja, si përbërës i sistemit të aktivizimit dytësor me një moment inercie më të lartë. Për të liruar sistemin ndihmës të parregullsisve të rrotullimit të boshtit të motorit, është zhvilluar për secilin aplikim të pulexhës së boshtit të motorit, pulexha e lire e dinamos që përbën një kit transmetimi të fuqisë rrotulluese të sistemit ndihmës dhe në të njëjtën kohë, garanton mungesën e zhurmës së dridhjeve. Kitet janë pajisur me udhëzime të aplikimit që tregojnë udhëzimet e montimit ose që paraqesin me detaje modelet në të cilat aplikohen.



**KIT I PULEXHËS NEW DAMPER
+ PULEXHA E DINAMOS + UDHËZIME**

Të gjitha produktet e gamës sonë kontribuojnë në popullimin e bazës së të dhënave "TecDoc", nga e cila vijnë direkt shumë nga sistemet më të zakonshme të kërkimit të kodeve dhe "e-commerce"-it të të gjithë zinxhirit të shpërndarjeve të pjesëve të këmbimit.

